

VENDIM
Nr.648, datë 28.7.2010

PËR AVOKATIN E TATIMPAGUESIT¹
(Ndryshuar me VKM nr.10, datë 11.1.2017)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6 të nenit 105/2 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Ky vendim ka për qëllim të përcaktojë kompetencat, detyrat funksionale dhe mënyrën e bashkëpunimit të Avokatit të Tatimpaguesve me strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe me palët e treta.

1. Shfuqizuar.

2. Roli i avokatit të tatimpaguesve

2.1 Në zbatim të legjislacionit tatimor, për të siguruar më shumë transparencë, përgjegjshmëri dhe integritet nga ana e administratës tatimore, Avokati i Tatimpaguesit garanton mbrojtjen dhe sigurimin e të drejtave të tatimpaguesve. Avokati i Tatimpaguesve, gjithashtu, ndihmon në përhapjen e informacionit për të drejtat e tatimpaguesve dhe edukimin e tyre.

2.2 Avokati i Tatimpaguesit shqyrton dhe analizon ankesat e paraqitura, investigon dhe ndërhyr për zgjidhjen e problemeve që u referohen ankesave të tatimpaguesve pranë drejtorive rajonale tatimore dhe/ose drejtorive funksionale në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

2.3 Avokati i Tatimpaguesit merr pjesë duke kontribuar në zbatimin e balancave të duhura ndërmjet barrës administrative të vendosur ndaj tatimpaguesve dhe përmbushjes së detyrimeve sipas legjislacionit tatimor.

2.4 Avokati i Tatimpaguesit analizon ankesat e paraqitura dhe rezultatet e shqyrtimeve dhe raporton te ministri i Financave, duke bërë propozime për përmirësime të mëtejshme procedurale e ligjore si dhe në administrimin tatimor e zbatimin e legjislacionit tatimor.

3. Autoriteti dhe funksionet

3.1 Avokati i Tatimpaguesit monitoron procedurat administrative tatimore me synim mbrojtjen e të drejtave të tatimpaguesve.

3.1.1 Avokati i Tatimpaguesit ndjek e vëzhgon përmbushjen e procesit të informimit e të shërbimit të tatimpaguesit prej administratës tatimore, në respektim të së drejtës që ka çdo tatimpagues për të marrë informacion dhe për t’u asistuar, pa shpërblim, nga administrata tatimore për kuptimin dhe zbatimin e legjislacionit tatimor. Ky proces përfshin, por nuk kufizohet në, informimin dhe publikimin e informacionit të qartë e të kuptueshëm në faqen elektronike të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në funksion të informimit dhe shërbimit. Monitorimi mund të kryhet edhe nëpërmjet sondazheve, vëzhgimeve, intervistave, pyetësorëve në mënyrë elektronike ose në çdo lloj forme tjetër, për t’u siguruar që kjo e drejtë e tatimpaguesit është përmbushur nga administrata tatimore.

3.1.2 Avokati i Tatimpaguesit sigurohet për të drejtën e trajtimit të paanshëm, profesional dhe etik të tatimpaguesit nga administrata tatimore, për çështje që kanë të bëjnë me detyrimet tatimore. Ai ndjek përmbushjen e detyrimit të administratës tatimore për nxjerrjen e qëndrimeve procedurale e teknike të unifikuara në zbatimin e legjislacionit për raste të njëjta, me qëllim një paraqitje profesionale të administratës tatimore.

¹ VKM nr.648, datë 28.7.2010 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.122/2010.
VKM nr.10, datë 11.1.2017 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.3/2017.

3.1.3 Avokati i Tatimpaguesit ndjek dhe sigurohet për zbatimin e së drejtës së tatimpaguesit për konfidencialitetin e të dhënave tatimore e financiare, të administruara nga administrata tatimore gjatë ushtrimit të funksioneve, te tatimpaguesi ose palët e treta.

3.1.4 Avokati i Tatimpaguesit sigurohet për zbatimin e së drejtës për njoftim të tatimpaguesit, sipas procedurës, mënyrës dhe formave të përcaktuara në legjislacionin tatimor. Tatimpaguesi duhet të njoftohet për çdo akt administrativ, veprim ose mosveprim, të bërë për mbledhjen e detyrimeve tatimore, i cili prek pasurinë e tij, me përjashtim të rasteve kur administrata tatimore vlerëson se ekziston rreziku real që, pas marrjes së njoftimit, tatimpaguesi ta transferojë pronësinë para përfundimit të vlerësimit tatimor.

3.1.5 Avokati i Tatimpaguesit ndjek e sigurohet për zbatimin e së drejtës për kontrolle të arsyeshme dhe në përputhje me përcaktimet, procedurat dhe afatet për kryerjen e kontrollit tatimor, periodicitetin e kryerjes së kontrolleve, kohën, vendin dhe kohëzgjatjen, sipas dispozitave të ligjit.

3.1.6 Avokati i Tatimpaguesit sigurohet për zbatimin e së drejtës së tatimpaguesit, në rastin e një mosmarrëveshjeje për një vlerësim tatimor, të kryer nga administrata tatimore, për të kërkuar dhe marrë përgjigje me shkrim, të arësyetuar, për arsyet, mënyrën e vlerësimit dhe të vendimit të marrë.

3.1.7 Avokati i Tatimpaguesit ndjek e sigurohet për zbatimin e së drejtës së tatimpaguesit për njohjen dhe pajisjen me vërtetime ose dokumentin zyrtar, të lëshuar nga administrata, për çdo të dhënë reale mbi situatën financiare tatimore të tij. Ai monitoron, gjithashtu, respektimin e së drejtës për të kërkuar nga administrata tatimore, në rrugë elektronike apo me shkrim, kopje të njësuara me origjinalin, për çdo dokument që ndodhet në dosjen e hapur për të, apo kopje të printuara e të certifikuara të të dhënave elektronike, të lidhura me të.

3.1.8 Avokati i Tatimpaguesit sigurohet për zbatimin e së drejtës së tatimpaguesit për t'u dëgjuar, kur ai e shpreh ose e kërkon atë, apo kur legjislacioni në fuqi e detyron administratën që, përpara marrjes së një vendimi, të dëgjojë tatimpaguesin.

3.1.9 Avokati i Tatimpaguesit sigurohet për zbatimin e së drejtës së ankimit prej tatimpaguesit, si kundrejt një akti administrativ për çështje tatimore, ashtu edhe kundrejt veprimeve ose mosveprimeve të punonjësve të administratës tatimore. Administrata tatimore, në çdo rast, duhet të sigurohet që nëpërmjet procedurave ose veprimeve të saj e drejta e tatimpaguesit për t'u ankuar dhe për të siguruar një shqyrtim të pavarur administrativ të mos cenohet.

3.2 Avokati i Tatimpaguesit ka autoritetin të ngarkojë drejtoritë rajonale tatimore për evidentimin e informacionit për shqyrtimin e ankesave të tatimpaguesve.

3.3 Avokati i Tatimpaguesit ka akses të sigurojë informacionin dhe dokumentacionin e administruar nga administrata tatimore, që lidhet me çështjet që ai shqyrton.

3.3/1 Avokati i Tatimpaguesve gëzon të drejtën e njohjes dhe të marrjes me shkrim, nga strukturat e administratës tatimore, të çdo informacioni të përgjithshëm apo të veçantë për një tatimpagues apo një grup tatimpaguesish, në çdo fazë të procesit administrativ. Ai mund të kërkojë informacion pranë çdo strukture të administratës tatimore, përfshirë Drejtorinë e Hetimit Tatimor, për aq sa nuk cenohen interesat e hetimit tatimor, siç përcaktohet në dispozitat ligjore në fuqi për këtë qëllim. Avokati i Tatimpaguesve gëzon të drejtën e njohjes dhe të marrjes së informacionit edhe nga strukturat përkatëse të shqyrtimit administrativ tatimor në Ministrinë e Financave.

3.3/2 Avokati i Tatimpaguesve, në bazë të kërkesës së tatimpaguesit, ka të drejtë t'i rekomandojë drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve nxjerrjen e vendimeve teknike, në përputhje me përcaktimet e nenit 10, të ligjit nr. 9920/2008. Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, në çdo rast, i kthen përgjigje të arsyetuar Avokatit të Tatimpaguesve për marrjen parasysish ose jo të rekomandimit, brenda një afati 30-ditor.

3.4 Avokati i Tatimpaguesit ka autoritetin t'i kërkojë shqyrtimin e një praktike drejtorisë rajonale tatimore për evidentimin e informacioneve dhe për shqyrtimin e ankesave të tatimpaguesve të veçantë.

3.5 Avokati i Tatimpaguesit ka autoritetin të bëjë kërkesë për shqyrtimin e një procedure

drejtuar drejtorive funksionale.

3.6 Avokati i Tatimpaguesit ka autoritet të rekomandojë përmirësimin e procedurave tatimore dhe, po të jetë rasti, edhe ndryshime në legjislacionin tatimor apo Kodin e Etikës së Administratës Tatimore.

3.7 Avokati i Tatimpaguesit ka autoritetin të referojë raste të veçanta te Drejtoria e Kontrollit Tatimor ose Drejtoria e Investigimit Tatimor, nëse informacioni apo dokumentacioni lidhur me një ankesë konkrete nga tatimpaguesit tregon se rasti në fjalë kërkon nisjen e procesit të kontrollit apo investigimit administrativ tatimor.

3.8 Avokati i Tatimpaguesit ka autoritet të rekomandojë përmirësimin e procedurave tatimore si dhe të rekomandojë lidhur me dispozitat e Kodit të Etikës.

3.8.1 Avokati i Tatimpaguesit nxjerr rekomandime me karakter të përgjithshëm, në lidhje me çështjet e identifikuara gjatë ushtrimit të funksioneve të tij, dhe i përdor ato si bazë për të bërë propozime për ndryshimin e legjislacionit përkatës.

3.8.2 Avokati i Tatimpaguesit nxjerr rekomandime me shkrim, drejtuar Drejtorisë së Apelit Tatimor ose Komisionit për Shqyrtimin e Apeliteve Tatimore dhe/ose i paraqet këto rekomandime në seancat dëgjimore administrative, të mbajtura nga Drejtoria e Apelit Tatimor ose Komisioni për Shqyrtimin e Apeliteve Tatimore.

3.9 Opinionet dhe rekomandimet e nxjerra nga Avokati i Tatimpaguesit duhet të trajtohen me përgjegjësi nga hallkat përkatëse të administratës tatimore.

3.10 Në rast mungese bashkëpunimi nga ana e punonjësve të administratës tatimore, Avokati i Tatimpaguesit njofton menjëherë dhe kërkon mbështetjen e eprorëve të atyre punonjësve, përkatësisht drejtorit rajonal apo drejtorit funksional.

3.11 Në rast se Avokati i Tatimpaguesit dhe një drejtor rajonal nuk bien dakord për zgjidhjen e duhur të një kërkesë për shqyrtim, Avokati i Tatimpaguesit dhe drejtori rajonal do t'ia paraqesin rastin zëvendësdrejtorit të Përgjithshëm Territorial që mbulon drejtorinë rajonale në fjalë. Nëse Avokati i Tatimpaguesit dhe një drejtor funksional në DPT nuk bien dakord për zgjidhjen e duhur të një kërkesë për shqyrtim, Avokati i Tatimpaguesit dhe drejtori funksional do t'ia paraqesin rastin zëvendësdrejtorit të Përgjithshëm që mbulon drejtorinë funksionale përkatëse.

3.12 Nëse Avokati i Tatimpaguesit dhe një zëvendësdrejtor i përgjithshëm nuk bien dakord për zgjidhjen e duhur të një rasti apo procedure, të dy së bashku do ta paraqesin problemin te drejtori i Përgjithshëm, i cili do të marrë vendimin përfundimtar për rastin në fjalë.

3.13 Avokati i Tatimpaguesit ka autoritetin të kërkojë marrjen e masave disiplinore për punonjësit në drejtoritë rajonale tatimore/drejtoritë funksionale pranë DPT-së, të cilët, nga analizimi i rasteve të shqyrtuara prej tij, rezulton se nuk respektojnë procedurat apo i shkelin ato me dashje.

3.14 Avokati i Tatimpaguesit nuk ka autoritet të përcaktojë detyrime tatimore ose të ndërhyjë në një rast që është në proces apeli. Avokati i Tatimpaguesit nuk ka autoritet të ndërhyjë në një rast që është në proces investigimi të brendshëm (antikorrupsioni) apo në proces investigimi kriminal tatimor. Avokati i Tatimpaguesit është i autorizuar të mos japë asistencë ndaj çdo tatimpaguesi, ankimi i të cilit duket i pabazuar dhe është paraqitur me qëllim që të vonojë veprimet e duhura të administratës tatimore.

4. Marrëdhëniet me strukturat e tjera të administratës tatimore dhe me palët e treta

4.1 Për përmbushjen e misionit e të detyrave dhe për të ushtruar normalisht autoritetin që i jep ligji dhe dispozitat nënligjore përkatëse, Avokati i Tatimpaguesit bashkëpunon me të gjitha drejtoritë rajonale e funksionale të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

4.2 Avokati i Tatimpaguesit mund të kontaktojë drejtpërdrejt personat përgjegjës në çdo sektor apo drejtori në drejtoritë rajonale e funksionale, pa pasur nevojë për ndonjë miratim paraprak nga eprori hierarkik i punonjësit që kontaktohet.

4.3 Avokati i Tatimpaguesit, në funksion të ushtrimit të detyrave të tij, mund të kontaktojë drejtpërdrejt institucione të tjera shtetërore apo private, organizatat e biznesit apo

profesionale, përfaqësuese të tatimpaguesve.

4.4 Avokati i Tatimpaguesit është anëtar i përhershëm i Këshillit Konsultativ Tatimor dhe merr pjesë edhe në forumet dhe organizimet e biznesit për çështje që lidhen me aspektet e administrimit tatimor dhe mund të iniciojë takime me bizneset, për diskutimin e situatave që kanë të bëjnë me probleme të procedurave të administrimit të tatimeve.

5. Raportimi

5.1 Avokati i Tatimpaguesit i raporton me shkrim, periodikisht, një herë në tre muaj, ose sa herë që ai e kërkon, ministrit të Financave. Në të njëjtën kohë, ky raport i dërgohet edhe drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.

5.2 Përveç raportimit periodik, në rastet kur e gjykon të arsyeshme, për situata apo çështje të veçanta, Avokati i Tatimpaguesit i raporton ministrit të Financave.

5.3 Raportimi duhet të përfshijë të dhëna statistikore lidhur me ankesat e paraqitura dhe rastet e shqyrtuara, gjetjet, rezultatet e arritura, si edhe konkluzione e rekomandime.

Për periudhën 1 qershor 2010 – 31 dhjetor 2010, burimet financiare për Avokatin e Tatimpaguesit do të përballohen nga Ministria e Financave brenda buxhetit ekzistues të këtij viti.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha